

SPECIFIKIME TEKNIKE

Per Objektiv: " SISTEMIMI I RRUGEVE TE BRENDESHME TE FSHATRAVE , FUSHE-VERRI VERGO DHE PALAVLI" BASHKIA DELVINE.

1 - Rafshim, nivelim, skarifikim t=10cm - Ky çmim përfshin teresine e punimeve me makineri qe lidhet me rafshimin nivelimin e skarifikimin e dheut ne cfaredo lloj toke ,ne te gjithë gjatesine e gjeresine e rruges e sheshit me trashesi t= 10cm per te kryjuar nje taban te qendrueshem te sheshit per te vazhduar me shtresat e tjera

Ky çmim i referohet 1m³

2 - Shtrese zhavor Tr-10 cm - Ky çmim përfshin teresine e punimeve dhe puntorise qe lidhet me blerjen ose prodhimin e zhavorit me trashesi minimale 10 cm, transportin dhe hedhjen e tij ne veper, ngjeshjen e tij me rrul , dhe sipas te gjitha kushteve teknike te zbatimit, si dhe cdo gje tjeter e nevojshme. Po ketu duhet te futet edhe kostoja e ngarkimit, transportit, shkarkimit ne objekt te zhavorit.

Ky çmim i referohet 1

4 - Shtrese Betoni M-200 T--12 cm per rrugen - Ky çmim përfshin teresine e punimeve dhe puntorise qe lidhen me blerjen ose prodhimin e betonit, , ngarkimin, transportin, shkarkimin, hedhjen, hapjen ne veper, shtrimin e zgarave te betonit, sipas kushteve teknike, sipas profilit te paraqitur ne projekt, me trashesi 12 cm sic percaktohet ne preventiv. . Pas hedhjes së kesaj shtrese duhet te zbatohen kushtet teknike te ngjeshjes se betonit dhe trajtimit te tij pas hedhjes ne veper.

Ky çmim i referohet 1 m³.

5. - Zgare celiku Ø4mm nen beton - Ky çmim përfshin teresine e punimeve me puntori qe lidhen me blerjen ,transportin dhe shtrirjen e tij mbi zhavor dhe lidhjen me njera tjetren .Ky process siguron qe betoni te punoj bashke me zgaren e celikut Ø4mm.

Ky çmim i referohet 1m² .

7.- Germimi kanali me makineri, -Ky çmim përfshin teresine e punimeve qe lidhen me germim te kanalit me makineri me skrep me goma sipas profilit te caktuar ne projekt, ngarkimin e materialeve ne automjetet e transport te tyre.Uji ne kanal do te nderpritet te porta e furnizimit me qellim qe te kryhen punime sa me te sakta. Qe me vone te kryhen dhe punime veshje me beton me puntori.

Punimet per montimin e tyre me puntori per 1ml tubacion.

10. - Ndertim murre betoni , Përfshin hapjen e themelit ,ndertimi i armatures se drasese me gjeresi si tek projekti dhe betonimi me beton te M-150 dhe ngjeshja e tyre me vibrator.

Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit te Territorit Delvine

Ing. Kastriot Muslimi

